

VENDIM
Nr. 248, datë 20.4.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS ‘ZIJA LUNIKU’, NË ZK 8527”, BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës ‘Zija Luniku’, në ZK 8527”, Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ullishte”, me një vlerë të përgjithshme prej 13 869 386.2 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 13 869 386.2 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë dy) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QE SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “NDËRTIMI I RRUGËS ‘ZIJA LUNIKU’ NË ZK 8527”, BASHKIA ELBASAN

NR.	TË DHËNAT E PRONËSISË			TË DHËNA KADASTRALE (SI PAS KARTELËS SË PASURISË)									TË DHËNAT E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN							SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)		
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Arë (m²)	Trrall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	ARË			TRUALL				VLERA TOTALE (lek)	
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)			
	A	B	C	G	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R		Z	
1	Gentian Desda	Artur Kadri	Guni Guni	Elbasan	8527	299/12	Ullishtë	1776	1776	0	0	16	90	89.5	222	19,869	0	-	-	19,869	Konfirmuar nga ASHK-ja	
2	Taulant Vpölca	Stefan Dedja	Dedja Dedja	Elbasan	8527	299/16	Ullishtë	136	136	0	0	16	94	2.6	222	577.2	0	-	-	577.2	Konfirmuar nga ASHK-ja	
3	Hennieta Emil Uran Bardhyl Ylli Silvana Elvira Pranvera Arjel Klodian	Kadri Abdyraman Abdyraman Abdyraman Mehmet Mehmet Mehmet	Fortuzi Këllici Këllici Këllici Këllici Prebala Pajuni Pajuni Pajuni	Elbasan	8527	306/75/3	Trrall	28300	0	28300	0	19	190	0	0	-	1085	12,764	13,848,940	13,848,940	Konfirmuar nga ASHK-ja	
	SHUMA																			13,869,386.20		